# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-428755**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Financimi i Grave Sipërmarrëse, Shqipëria bëhet pjesë e nismës “WE Finance Code Albania” – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/financimi-i-grave-sipermarrese-shqiperia-behet-pjese-e-nismes-we-finance-code-albania/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 16:53:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 11:41:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 3784c2a02f707bf49e808a3413fa52f7067212507899ff350269cba60ecdfb51 |
| TEKSTI | 76058048cc992e7ed9fbb38c6bd1fbafd37f3cc2928f91784f343e8708825929 |
| PAMJA | 645e139a75caf550be8eb9e8f2c518535567d7a02131d7b2b843c13a4d77d704 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 71aa7441e097cb173031922358e17bc303bbc1428814f0f65742aa880d19a48e |
| E MËPARSHMJA | 1d8cf7fad97d4ee0489b9b040af322d26ae7e9afb8a83c24caeccb79b607aa3e |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/71aa7441e097cb173031922358e17bc303bbc1428814f0f65742aa880d19a48e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Banka e Shqipërisë dhe ajo Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, organizuan ditëne sotme ceremoninë për lançimin e “WE Finance Code Albania – Kodi për Financimin e Grave Sipërmarrëse”, duke shënuar fillimin e një partneriteti kombëtar për të avancuar aksesin në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME) të drejtuara apo në pronësi të grave.

Në fjalën e tij, Guvernatori Sejko e vlerësoi këtë nismë si një angazhim të rëndësishëm që synon të mbështesë zhvillimin e sipërmarrjes së grave, përmes një qasjeje të bazuar në të dhëna, bashkëpunimit institucional dhe veprimeve konkrete.

Në Shqipëri, Banka e Shqipërisë ka marrë rolin e koordinatores kombëtare, duke udhëhequr ndërtimin e një ekosistemi të përbashkët të institucioneve publike dhe financiare që angazhohen për një treg financimi më gjithëpërfshirës.

Në vijim, Guvernatori vuri në dukje angazhimin e Bankës së Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi financiar modern, përmes infrastrukturës financiare bashkëkohore, zgjerimit të aksesit në shërbimet financiare, forcimit të edukimit financiar, si dhe përmirësimit të cilësisë dhe përdorimit të të dhënave financiare.

Në përfundim, Guvernatori Sejko vlerësoi bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë nismë dhe theksoi se suksesi i saj do të matet nga mundësitë reale që do të krijohen për gratë sipërmarrëse në vend

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Një nga rezultatet konkrete të nismës është krijimi i panelit analitik kombëtar të financimit të MSME-ve. Ky instrument krijon një bazë të re njohurie për tregun, duke bërë të mundur analizimin e integruar të informacionit mbi kreditë dhe depozitat me karakteristikat e bizneseve – si gjinia e pronësisë, madhësia e ndërmarrjes, sektori ekonomik, rajoni dhe forma juridike. Paneli do të jetë i aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë dhe do të shërbejë si një instrument i ri për analizë, transparencë dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Në vijim të ceremonisë u zhvillua një panel diskutimi me pjesëmarrjen e Zëvendësguvernatores së Dytë të Bankës së Shqipërisë, znj. Natasha Ahmetaj, dhe të përfaqësuesve të sektorit bankar dhe të institucioneve publike, ku u diskutua se si bashkëpunimi ndërinstitucional dhe përdorimi i të dhënave mund të mbështesin zhvillimin e produkteve financiare më të përshtatshme dhe politikave më efektive për sipërmarrjen e grave.

Lançimi i "ËE Finance Code Albania" shënon fillimin e një procesi afatgjatë, në të cilin institucionet nënshkruese do të punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të dhënave, për të monitoruar progresin dhe për të krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e sipërmarrjes së grave në Shqipëri.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të kontribuojë, në përputhje me mandatin e saj, për një sistem financiar modern, të qëndrueshëm, efikas dhe gjithëpërfshirës, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës financiare, cilësinë e statistikave dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

#grate #sipermarrja #vizionplsu

**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



EKONOMI
**Kërkohet më shumë kredi për shtëpi,...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 17:01

EKONOMI
**Nisma e qeverisë për strehimin social,...**
Taulant Halili · 11 Sht

EKONOMI
**U kallëzua në SPAK, ministri i Financave...**
Redaksia Web · 10 Sht

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.